



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1858/ 5 prot.

Datë 19.08.2026

V E N D I M
Nr. 1009 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Adenis Kastrati” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, shërbime me Nr. REF-85449-05-13-2026, me objekt “Shërbime të Printimit dhe Publikimit”, me fond limit: 1,249,984 Lekë pa TVSH, zhvilluar 25.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK me NIPT K21511002I
Adresa: Rr. Xhorxh Soros, Nr. 1524, L. 18 shtatori , Gjirokastrë
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Tiranë.
Adresa: Rr, “Bilal Golemi”, Godina nr. 29, Tiranë.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Adenis Kastrati”, P.F me NIPT L51611004I, Adresa: Rr. “Bulevardi Nene Tereza”, Nr pasurie 9/22 dhe Z.K 2066, Kati 2, Kamëz, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.05.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbim , me Nr. REF-85449-05-13-2026, me objekt “Shërbime të Printimit dhe Publikimit”, me fond limit: 1,249,984 Lekë pa TVSH, zhvilluar 25.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 04.06.2026 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës si vijon:

Operatorët ekonomikë		Vlerat e ofertave	Vlerësimi
1	INSTANT.AL ShPK	573,140	Skualifikuar
2	Adenis Kastrati P.F	714,890	Kualifikuar
3	IN PRINT ShPK	749,264	Kualifikuar
4	TE Electronics ShPK	765,264	Skualifikuar
5	InfoSoft Office ShPK	937,488	Kualifikuar
6	PC STORE ShPK	937,520	Kualifikuar
7	AICOM ShPK	968,796	Kualifikuar

II.3. Nga verifikimet e kryera në SPE Autoriteti Kontraktor më datë 05.06.2026 ka publikuar Formularin e Njoftimit të Fituesit Paraparak.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6785, datë 11.06.2026 dhe me Nr. 1858/2026 Prot., datë 12.06.2026, nga operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbim , me Nr. REF-85449-05-13-2026, me objekt “Shërbime të Printimit dhe Publikimit”, me fond limit:

1,249,984 Lekë pa TVSH, zhvilluar 25.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Adenis Kastrati P.F në procedurën e prokurimit sipërcituar, me pretendime se:

1-Nuk ka plotësuar piken 2.2.4 pika b) autoriteti kontraktor ka kerkuar qe pajisjet me specifikimet teknike si me poshte: Për të realizuar sistemin e menaxhimit të shërbimit të printimit/fotokopjimit/skanimit kërkohen pajisje me specifikimet të pasqyruara në specifikimet teknike:

10 pajisje printer/fotokopje/skaner A4 me ngjyra

4 pajisje printer/fotokopje/skaner A4 me ngjyra

3 pajisje printer/fotokopje/skaner A3 bardhë e zi me specifikimet e kërkuara ...

Kerkojme skualifikimin e operatorit Adenis Kastrati pasi gjykojme qe broshurat e pajisjeve te dorezuara prej tij nuk plotesojne specifikimet e kerkuara ne DST për pajisjet A4 me ngjyra, A4 me ngjyra dhe A3 bardhë e zi.

II.4.1. Bazuar në nenin 112 pika pika 4, germa “b” dhe “c” të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe si dhe Formularin e Publikimit nr. 1858/1 prot., datë 15.06.2025, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.5. Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr. 1284/11 Prot., datë 13.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1858/2, datë 18.06.2026, me objekt “Kthim pergjigje pr ankesën në lidhje me procedurën e prokurimit Shërbime të Printimit dhe Publikimit”, autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin nr. 322, datë 16.06.2026 të KSHA-së mbi mospranim të pretendimeve të ankesës së operatorit ekonomik “IN PRINT” ShPK.

II.6. Në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nuk janë paraqitur në SEA argumente nga operatorë të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “IN PRINT” SHPK për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Adenis Kastrati” P.F me arsyen si vijon:

“Nuk ka plotësuar piken 2.2.4 pika b) autoriteti kontraktor ka kerkuar qe pajisjet me specifikimet teknike si me poshte: Për të realizuar sistemin e menaxhimit të shërbimit të printimit/fotokopjimit/skanimit kërkohen pajisje me specifikimet të pasqyruara në specifikimet teknike:

10 pajisje printer/fotokopje/skaner A4 me ngjyra

4 pajisje printer/fotokopje/skaner A3 me ngjyra

3 pajisje printer/fotokopje/skaner A3 bardhë e zi me specifikimet e kërkuara ...

Kerkojme skualifikimin e operatorit Adenis Kastrati pasi gjykojme qe broshurat e pajisjeve te dorezuara prej tij nuk plotesojne specifikimet e kerkuara ne DST per paisjet .”

III.1.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST, **shtojcën 9**, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.2 Për kapacitetin teknik:

2.2.4 Operatori Ekonomik me anë të një deklarate të sigurojë realizimin e shërbimit sipas specifikimeve teknike të listuara si më poshtë:

b) **Specifikimet teknike për pajisjet që do të përdoren në këtë procedurë:**

Për të realizuar sistemin e menaxhimit të shërbimit të printimit/fotokopjimit/skanimit kërkohen pajisje me specifikimet të pasqyruara në specifikimet teknike:

- 10 pajisje printer/fotokopje/skaner A4 me ngjyra
- 4 pajisje printer/fotokopje/skaner A3 me ngjyra
- 3 pajisje printer/fotokopje/skaner A3 bardhë e zi

Paisje me ngjyra A4

Parametri	Specifikimi
Lloji	Fotokopje / Printer / Skaner
Teknologjia	Laser me ngjyra
Shpejtësia min	30–40 faqe/min
Ekrani	Jo më i vogël se 6–10.1 inch
Rezolucioni min	1200 x 1200 dpi
Dimensioni max (W x D x H)	500 x 570 x 510 mm
Kapaciteti i sirtarëve	Jo më i vogël se 250 faqe
Kapaciteti në dalje	Jo më i vogël se 200 faqe
Madhësia e letrës	A4
Memoria	Jo më e vogël se 2 GB
HDD	Jo më i vogël se 250–320 GB
Aplikacione	Instalim aplikacionesh dhe aplikacion për monitorim /menaxhim printimi
Connection	Ethernet, USB
Skanim në HDD	Mundësi skanimi në HDD dhe krijim folderash për përdorues
Skanim	Full Network Color Scan (Email, Folder, USB)
Kapaciteti SPDF/DADF min	50 faqe
Mobile Printing	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure Printing	Enkriptim i hardiskut për ruajtjen e informacionit
Duplex	Po
Cloud Scan	Skanim direkt në Dropbox, SharePoint, iCloud, etj.

Paisje A3 Bardh e Zi

Parametri	Specifikimi
Lloji	Fotokopje / Printer / Skaner
Teknologjia	Laser Bardh/Zi
Shpejtësia min	30–40 faqe/min

Ekrani	Jo më i vogël se 6–10.1 inch
Rezolucioni min	1200 x 1200 dpi
Dimensioni max (E x D x H)	450 x 550 x 700 mm
Kapaciteti i sirtarëve	Jo më i vogël se 500 faqe
Kapaciteti në dalje	Jo më i vogël se 250 faqe
Madhësia e letrës	A4–A3
Memoria	Jo më e vogël se 2 GB
HDD	Jo më i vogël se 250–320 GB
Aplikacione	Instalim aplikacionesh dhe aplikacion për monitorim/menaxhim printimi
Connection	Ethernet, USB
	Mundësi skanimi në HDD dhe krijim folderash për përdorues
Skanim në HDD	Full Network Scan (Email, Folder, USB)
Skanim	50 faqe
Kapaciteti SPDF/DADF min	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Mobile Printing	Enkriptim i hardiskut për ruajtjen e informacionit
Secure Printing	Po
Duplex	Skanim direkt në Dropbox, SharePoint, iCloud, etj.
Cloud Scan	

Paisje A3 me ngjyra

Parametri	Specifikimi
Lloji	Fotokopje / Printer / Skaner
Teknologjia	Laser me ngjyra
Shpejtësia	30–40 faqe/min
Ekrani	Jo më i vogël se 6–10.1 inch
Rezolucioni	1200 x 1200 dpi
Dimensioni max (W x D x H)	590 x 685 x 965 mm
Kapaciteti i sirtarëve	Jo më i vogël se 500 faqe
Kapaciteti në dalje	Jo më i vogël se 250 faqe
Madhësia e letrës	A4–A3
Memoria	Jo më e vogël se 2 GB
HDD	Jo më i vogël se 250–320 GB
Aplikacione	Instalim aplikacionesh dhe aplikacion për monitorim/menaxhim printimi
Connection	Ethernet, USB
	Mundësi skanimi në HDD dhe krijim folderash për përdorues
Skanim në HDD	Full Network Color Scan (Email, Folder, USB)
Skanim	50 faqe
Kapaciteti SPDF/DADF	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Mobile Printing	Enkriptim i hardiskut për ruajtjen e informacionit
Secure Printing	Po
Duplex	Skanim direkt në Dropbox, SharePoint, iCloud, etj.
Cloud Scan	

LOGJISTIKA DHE KOHA

- Vendi i lëvrim të kryerjes së shërbimit:
Tiranë, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

- b. Afati i kontratës dhe periudha e implementimit të detyrave zgjat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Shënim : Në të gjitha rastet kur është përdorur fjala markë ose emër, njihet një vlefshmëria /barazvlefshmëria ose ekuivalent.

III.1.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se, operatori ekonomik “ Adenis Kastrati” P.F ka dorëzuar si pjesë të ofertës:



Deklarate_per_Pajisjet_Stafin_dhe_Mjetet.pdf

Në përmbushje të kriterit 2.2.4. në brendi të të cilit gjendet dokumenti i plotësuar si vijon:

Tiranë me, 25.05.2026

DEKLARATË

(për pajisjet- stafin- mjetet)

Adenis Kastrati PF, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë **25.05.2026 11:00** nga Autoriteti Kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, me objekt **“Sherbime te printimit dhe publikimit”**, me nr. **REF-84343-05-05-2026** dhe fond limit **1.249.984,00 (Një milion e dyqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër)** pa TVSH.

Unë i nënshkruari Adenis Kastrati, me cilësinë e Administratorit të personit fizik Adenis Kastrati PF, deklaroj se:

angazhohem se zotëroj të gjithë mjetet, pajisjet teknike dhe fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e shërbimit objekt prokurimi. Gjithshtu siguroj se marr përsipër funksionimin e të gjitha pajisjeve dhe zëvendësimin e tyre në rast nevojë. Në rast defekti apo mosfunksionimi të pajisjeve, do të ndërhyjë për riparimin ose zëvendësimin e tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor, në mënyrë që të mos pengohet aktiviteti i institucionit.

Data e dorëzimit të deklaratës **25.05.2026**

Përfaqësuesi i ofertuesit **Adenis Kastrati**

Nënshkrimi

Vula



III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.4. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve dhe kërkesave për t’u plotësuar nga ofertuesit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës objekt-prokurimi.

Autoriteti kontraktor ka përgjegjësi për zhvillimin e procedurës së prokurimit, vlerësimin e ofertuesve në përputhje me dokumentet standarde të publikuara në SPE.

Në plotësimin e dokumentacionit të ofertës, operatorët ekonomikë janë subjektet e interesuara dhe duhet t’i përmbahen me rigozitet dokumenteve të publikuara në DST, duke plotësuar të gjitha dokumentet siç ato janë përcaktuar nga autoriteti kontraktor si dhe të detyrueshme për t’u plotësuar nga të gjithë operatorët ekonomikë të cilët ofertojnë në procedurat e prokurimit përsa kohë i kanë pranuar ato.

Në rastin konkret, nisur nga pretendimet e ankimesit Komisioni kreu verifikimet mbi dokumentacionin e ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, nga operatori ekonomik Adenis Kastrati P.F, nga ku konstatohet, se operatori ka dorëzuar si pjesë të ofertës së tij, dokumentin Deklaratë për Pajisjet Stafin dhe Mjetet, në përmbushje të kriterit kualifikues 2.2.4. cituar dokumenti i plotë më sipër në pikën III.1.1.

Nga verifikimi i dokumentit të ofertës së Operatorit ekonomik konstatohet se dokumenti është i plotësuar me firmë dhe vulë si edhe në datën përpara vlerësimit të ofertave, duke rezultuar i rregullt në formë dhe përmbajtje mbi përmbushjen e kriterit 2.2.4 dhe jo vetëm.

Përsa konstatuar dhe analizuar Komisioni gjykon se operatori ekonomik Adenis Kastrati P.F ka përmbushur kriterin 2.2.4. të shtojcës 9, me paraqitjen në SPE të dokumentit Deklaratë për Pajisjet Stafin dhe Mjetet.

Pretendimet e ankimesit nuk qëndrojnë.

III.1.5. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë:

*Kerkojme skualifikimin e operatorit Adenis Kastrati pasi gjykojme **që broshurat e pajisjeve të dorëzuara prej tij nuk plotësojnë specifikimet teknike 1.Për pajisjet A4 me ngjyra, 2. Pajisjet A3 Bardh e Zi, 3. Pajisje A3 me ngjyra. e kerkuara ne DST.***”, Komisioni mori në shqyrtim DST nga verifikimi i të cilave, rezultoi, se në shtojcën 9, janë përcaktuar Kriteret e Përgjithshme dhe Kriteret e Veçanta për Kualifikim, nga ku nuk evidentohet të jetë përcaktuar ndonjë kërkesë/kriter për paraqitje nga ofertuesit **broshurat e pajisjeve**, madje në asnjë vend të dokumenteve të tenderit objekt shqyrtimi nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë e tillë ndaj **paraqitja apo mosparaqitja e broshurave të pajisjeve**, pretenduar nga ankimesi nuk mund të përbëjë shkak për kualifikimin/skualifikimin e një operatori ekonomik.

Për pasojë, gjykojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në rastin në shqyrtim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar **paraqitja e broshurave të pajisjeve**, rrjedhimisht, autoriteti kontraktor nuk mund të vlerësojë mbi kritere të cilat nuk janë kërkuar nga ana e tij, në dokumentet e tenderit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Adenis Kastrati” P.F në këtë procedurë prokurimi, është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në mënyrë të qartë Ligji “Për Prokurimin Publik” parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga nenin 3 i *lex specialis*, “Parime të përgjithshme” që të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe me transparencë e në mënyrë proporcionale të kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Përsa konstatuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues janë ngritur mbi kërkesa/kritere të pa kërkuara në DST.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “IN PRINT” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbim , me Nr. REF-85449-05-13-2026, me objekt “Shërbime të Printimit dhe Publikimit”, me fond limit: 1,249,984 Lekë pa TVSH, zhvilluar 25.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapa të mëtejshëm procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës që të derdhë në buxhetin e shtetit tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik “IN PRINT” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Kryetar
Ismail Shehu

